



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE PUBLIKE

Nr. 6483 Prot.

Durrës, më 29.5. 2024

URDHËR

Nr. 179 Datë 29.5. 2024

“MBI ORGANIZIMIN E PLANIT TË LËVIZJES SË AUTOMJETEVE NË QYTETIN E DURRËSIT NË KUADËR TË SEZONIT TURISTIK DUKE FILLUAR NGA DATA 01.06.2024 DERI MË DATË 15.09.2024”

Me qëllim riorganizimin e lëvizjes së automjeteve në Qytetin e Durrësit dhe në mbështetje të nenit 7 pika 2, nenit 11 pika 3 shkronja “ç”, nenit 44 shkronja “a”, të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore” i ndryshuar; nenit 5 pika 3, nenit 7 pika 1 dhe 4, nenit 21 pika 2 dhe 3, nenit 37 pika 1 shkronja “b” të ligjit nr. 8378, datë 22.07.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, nenit 8, nenit 121, 122, 124, 125 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, Udhëzimit të MPPTT-së nr. 15 datë 24.07.2007 “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licensave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor i ndryshuar.

URDHËROJ:

1. Ndalimin e qarkullimit të mjeteve ATP (automjet të transportit të përzier), me masë maksimale të autorizuar deri në 3.5 ton, si më poshtë:
 - hënë - premte, ndalim qarkullimi ora 09:00-13:00 dhe 16:00-22:00;
 - shtunë, ndalim qarkullimi ora 09:00-22:00
 - diel, ndalim qarkullimi 24 orë.
2. Ndalimin e qarkullimit të mjeteve të transportit, me masë maksimale të autorizuar 3.5-7.5 ton, si më poshtë:
 - hënë - premte, ndalim qarkullimi ora 09:00-22:00;
 - shtunë, ndalim qarkullimi ora 07:00-22:00
 - diel, ndalim qarkullimi 24 orë.
3. Ndalimin e qarkullimit të mjeteve me tonazh të rëndë ATV (automjet të transportit të veçantë) me masë maksimale të autorizuar mbi 7.5 ton (betoniere, kamionë, trajler, etj), si më poshtë:
 - hënë - premte, ndalim qarkullimi ora 07:00-22:00;
 - shtunë - diel, ndalim qarkullimi 24 orë.

4. Zona e kufizimit të qarkullimit do të jetë përgjatë rrugës Adria, Dëshmorëve, rrugës Aleksandër Goga (deri te Drejtoria e Policisë), Bulevardi Epidamn, Shëtitorja Taulantia, Rruga e Currilave, Rruga Egnatia, Rruga Mars 91, Rruga Hysen Kërtusha, Rruga Mujo Ulqinaku, Rruga Glaukia, Rruga Stefan Kaçulini, Rruga Pavarësia, si dhe rruga dytësore Plepa – Përroi i Agait, sipas planvendosjes bashkëlidhur.
5. Subjektet tregtare do të kryejnë veprimtarinë e tyre furnizuese sipas orarit përkatës dhe sinjalistikës së vendosur.
6. Lejohet qarkullimi i të gjitha mjeteve të policisë, urgjencës, zjarrfikësve, Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Durrës, Ndërmarrjes së Shërbimeve Komunale Plazh, Agjencisë së Parqeve Urbane, Ndërmarrjes Rruga, dhe mjetet e transportit publik urban.
7. Qarkullimi i mjeteve gjatë kufizimit të vendosur nëpërmjet këtij Urdhëri, do të kryhet vetëm sipas autorizimeve përkatëse të lëshuar nga Bashkia Durrës.
8. Ndërmarrja Rruga duhet të vendosë sinjalistikën e përcaktuar në këtë Urdhër brenda 5 ditëve.
9. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Ndërmarrja Rruga, Policia Bashkiake, Drejtoria e Policisë së Qarkut Durrës, Sektori i Qarkullimit Rrugor.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Emiriana Sako





RRUGA HYSEN KERTUSHA

RRUGA ALEKSANDER GOGA

RRUGA MUJTO ULQINAKU

RRUGA GJALOKA

RRUGA STEFAN KARAJI

RRUGA E DËSHMOREVE

RRUGA ADRIA

RRUGA ALEKSANDER GOGA

RRUGA 91 MARS

RRUGA GJURILIANI

RRUGA EGONIA

RRUGA TAULANTA

BULEVARDI ERIDANI



1:10,000



RRUGA PAVARÉSIA

RRUGA LIRIA

RRUGA DURRES-KAVANDEJ



1:25,000